

MEMORANDUM I MIRËKUPTIMIT PËR BASHKËPUNIM TË NDËRSJELLTË

në mes të

Kolegjit UNI –Universum International College Powered by Arizona State University

Dhe Tre Pharm Sh.p.k.

Neni 1

Qëllimi i Memorandumit

1. Përmes këtij memorandumi të mirëkuptimit palët nënshkruese kanë shprehur vullnetin dhe gatishmërinë për bashkëpunim, duke synuar ngritjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të njohurive profesionale dhe akademike, dhe ndërlidhjen e mësimit akademik me punë praktike dhe anasjelltas.

Neni 2

Fushëveprimtaria

1. Përmes këtij memorandumi të mirëkuptimit, Prodhuesi Trepharm do t'u mundësoj sipas nevojave të kompanisë, studentëve të Programeve Shëndetësore të Kolegjit UNI punën praktike në Kompaninë Trepharm me kohëzgjatje dhe numër të dakorduar në mes të palëve.
2. Me anë të këtij memorandumi të mirëkuptimit, Kolegji UNI do t'u mundësoj studentëve vizitat studimore, të përcaktuar nga përgjegjësi i caktuar nga Trepharm në Prishtinë, vizitat studimore që do të organizohen për studentet tanë në Kompani dhe për ndonje pajisje dhe medikamente që mund të furnizohemi nga Kompania juaj për nevojat e Kolegjit gjatë zhvillimit të studimeve pasi që jeni prodhues i shumë asortimeve. Ne gjithashtu mund të bejmë edhe analizat e ndryshme që ju i ofroni në Laboratorin tuaj testues të produkteve pasi që ju jeni të certifikuar për këtë veprimtari.
3. Kolegji UNI do të siguroj që kandidatët e përzgjedhur të jenë të nivelit të kënaqshëm dhe të kenë potencial për avancim në karrierën e tyre akademike dhe profesionale.

Neni 3

1. Palët pajtohen se numri i studentëve të angazhuar për punë praktike do të caktohet varësisht nga kërkesat e Trepfarm gjatë muajit Gusht-Shtator për vitin akademik pasues.
2. Praktika profesionale do të mbahet çdo ditë pune dhe në përputhshmëri me dispozitat ligjore të përcaktuara në Ligjin e Punës. Kohështirja e fondit të orëve mund të jetë fleksibile, në përputhje me kohën e provimeve dhe ligjëratave, sipas marrëveshjes mes Kolegjit Universum dhe Trepfarm.
3. Palët në marrëveshje do të kenë përgjegjësi të plotë gjatë përgatitjes së projekteve nga fushat e bashkëpunimit.
4. Palët në marrëveshje pajtohen që gjatë implementimit të projekteve dhe aktiviteteve nga fushat e cekura të mos cenojnë veprimtarinë e palës tjetër.

Zbatimi i memorandumit

Neni 4

1. Kjo marrëveshje nuk detyron ligjërisht asnjërin, mirëpo shërben si marrëveshje e vullnetit të mirë mes dy palëve. Përfundimisht nga ky paragraf, neni 5 dhe 6 i kësaj marrëveshje kanë implikime dhe detyrime ligjore.
2. Me nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje, palët pajtohen që të bashkëpunojnë, duke përfshirë, por pa u kufizuar në ofrimin e këshillave profesionale të dyanshme në fushën e kimisë, si dhe mundësimin të vijimit të praktikave profesionale për studentët e këtij fakulteti në Trepfarm dhe te partnerët e Trepfarm.
3. Me qëllim të ruajtjes së të dhënave personale për bizneset dhe studentët, palët pajtohen që të zbatohen dispozitat e Ligjit nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, i publikuar në Gazetën Zyrtare më dt. 20.02.2019.
4. Të gjitha të dhënat dhe dokumentet me të cilat disponon Trepfarm, pavarësisht faktit a ekzistojnë në kohën e themelimit të këtij bashkëpunimi, praktikantët dhe të arritura përmes angazhimit përmes këtij bashkëpunimi ose nga personeli tjetër i Trepfarm, do të jenë pronë e Trepfarm, dhe këto të dhëna mund të përdoren edhe nga praktikanti për zhvillimin e tij në karrierë.
5. Palët pajtohen që pas përfundimit të këtij bashkëpunimi, do t'i kthehen Trepfarm të gjitha manualët, regjistrimet, dokumentet, materialet trajnuese dhe materialet e tjera konfidenciale të tij, si dhe të gjitha pajisjet që i janë dhënë të praktikantit për kryerjen e detyrave të tij.

Konfidencialiteti

Neni 5

1. Universiteti dhe Praktikantët janë të obliguar të mbajë të dhënat e Trepfarm dhe të klientëve të Trepfarm në konfidencialitet të plotë gjatë marrëdhënies së punës praktike edhe pas ndërprerjes së marrëdhënies së punës praktike.
2. Të dhënat konfidenciale përfshijnë por nuk kufizohen në: emrat apo të dhënat e klientëve të Trepfarm; strategjinë e punës së Trepfarm; informatat që lidhen me shërbimet dhe stafin e Trepfarm; raportet e brendshme dhe shkresat e Trepfarm; informatat dhe fshehtësitë e ndryshme të punës së Trepfarm, përfshirë informatat e përbëra nga formulat, programet, modelet, mjetet, zhvillimet, proceset, përpunimi i të dhënave dhe informatave, dosjeve dhe specifikacioneve, vizatimeve, artikujve etj.
3. Gjatë kohëzgjatjes së punës praktike, praktikantet dhe universiteti do të ketë qasje dhe do të njoftohet me përmbajtjen e të dhënave konfidenciale të përshkruara në paragrafin paraprak dhe të njëjtat do t'i përdor vetëm për qëllim të realizimit të detyrave të punës, por jo edhe për qëllime private.
4. Çfarëdo shkelje e konfidencialitetit nga praktikanti gjatë marrëdhënies së punës praktike, mirëpo edhe pas shkëputjes, nënkupton shkelje materiale të kësaj kontrate dhe marrje në përgjegjësi materiale për dëmin e shkaktuar.

Pronësia Industriale

Neni 6

1. Të gjitha të dhënat dhe dokumentet me të cilat disponon Trepfarm, pavarësisht faktit a ekzistojnë në kohën e punësimit në punë praktike, të arritura përmes angazhimit të praktikantit, ose nga personeli tjetër i Univesitetit, do të jenë pronë e Trepfarmit.
2. Praktikanti dhe univesiteti për pajtohet që pas përfundimit të punës praktike, do t'i kthejë Trepfarm të gjitha manualet, regjistrimet, dokumentet, materialet trajnuese dhe materialet e tjera konfidenciale të Trepfarm.
3. Çdo zhvillim, material, krijim, zbulim apo prodhim qoftë shkencore apo aritistike gjatë periudhës së kësaj marrëveshje dhe punës praktike që kryhet nga kjo marrëveshje e pranë Trepfarm, është pronë dhe mbetet pronë e Trepfarm.
4. Prona intelektuale dhe materialet tjera të zhvilluara gjatë punës tek Trepfarm nuk mund të përdoren nga praktikanti apo univesiteti në asnjë formë në të ardhmen për ndonjë institucion, kompani, publikim apo transfer tek persona tjerë, pa autorizimin me shkrim të Trepfarm.

Vlefshmëria, ndryshimet dhe plotësimet

Neni 7

1. Ky memorandum nënshkruhet në afat të pacaktuar.
2. Ndryshimet dhe plotësimet e këtij memorandumi bëhen me pajtim të të dyja palëve.
3. Ky memorandum do të përfundojë me marrëveshje nga të dyja palët Ose me tërheqje të njërës palë, duke e lajmëruar me shkrim palën tjetër, së paku 1 (një) muaj përpara.

Dispozitat përfundimtare

Neni 8

Ky memorandum përpilohet në gjashtë kopje identike. Për secilën palë nga dy kopje.

Memorandumi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga të dyja palët.

Prishtine, më: 20.06.2024

PALËT NËNSHKRUESE

Kolegji UNI – Universum


Alejtin Berisha
Drejtori Ekzekutiv



Trepfarm Sh.p.k.


Drejtori Ekzekutiv/Menaxheri

